



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

VENDIM PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES

Neni 1 Përbërja

Me këtë Vendim formohet grupi punues për hartimin e Draft-Rregullores për organizimin e punës në Institucionet Edukative-Arsimore të Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtoratit për Arsim, kryesues,
2. Vlora Krasniqi, Shefe e Sektorit për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore, anëtare
3. Driton Sadiku, Drejtor i SHFMU "Ismail Luma" Lipjan, anëtar,
4. Liridon Duhaku, Sekretar në shkollen profesionale "Adem Gllavica" Lipjan, anëtar
5. Besarta Trolli, Psikologe, anëtare,
6. Mexhide Gashi, Zyrtare në Drejtoratin për Arsim, anëtare dhe
7. Shemsi Gajtani, nga Këshilli i Prindërve, Lipjan.

Neni 2 Detyrat e grupit punues

1. Grupi punues ka për detyrë hartimin Draft - Rregullores për organizimin e punës në Institucionet Edukative-Arsimore të Komunës së Lipjanit. Grupi punues do të bëjë hartimin e Draftit të Rregullores për organizimin e punës në Institucionet Edukative-Arsimore të Komunës së Lipjanit duke u bazuar në dispozitat përkatëse ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Grupi punues duhet t'i ndjekë procedurat e konsultimit publik sipas dispozitave ligjore përkatëse dhe të mbajë takim publik të hapur duke mbajtur procesverbal në bashkëpunim me Zyrtaren përgjegjës për konsultime publike të Komunës së Lipjanit.

Neni 3 Hryja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi, anëtarët e Grupit punues dhe Zyrtarja për Konsultime me Publikun.

1Nr. 020/04-16115
Lipjan, më 25.03.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

VENDIM PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES

Neni 1 Përbërja

Me këtë Vendim formohet grupi punues për hartimin e Draft-Statutit të Qendrës për Punë Sociale (QPS-së) së Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Makfirete Shamolli, Drejtoreshë e QPS-së në Lipjan, kryesuese,
2. Lorik Bërbatovci, Qendra për Punë Sociale, anëtar,
3. Valdete Muji, Sektori për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore, anëtare,
4. Zyrafete Mavriqi - Bytyqi, Qendra për Punë Sociale, anëtare dhe
5. Gafurr Hetemi, Zyra e Kryetarit të Komunës, anëtar.

Neni 2

Detyrat e grupit punues

1. Grupi punues ka për detyrë hartimin Draft - Statutit të Qendrës për Punë Sociale të Komunës së Lipjanit. Grupi punues do të bëjë hartimin e Draftit të Statutit Qendrës për Punë Sociale të Komunës së Lipjanit duke u bazuar në dispozitat përkatëse ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Grupi punues duhet t'i ndjekë procedurat e konsultimit publik sipas dispozitave ligjore përkatëse dhe të mbajë takim publik të hapur duke mbajtur procesverbal në bashkëpunim me Zyrtaren përgjegjës për konsultime publike të Komunës së Lipjanit.

Neni 3

Hryja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesja, anëtarët e Grupit punues dhe Zyrtarja për Konsultime me Publikun.

1Nr.020/04-15555

Lipjan, më 22.03.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43474 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-9779 e datës 15.02.2024, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E
KËRKESAVE TË FERMERËVE

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të fermerëve konform shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-9779 e datës 15.02.2024 të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari për implementimin e projektit : subvencionimi i qumështit për litër, (në vazhdim të tekstit Komisioni), në këtë përbërje:

1. Afrim Sadiku, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, Kryesues
2. Hazbi Ademi, Zyra e Kryetarit të Komunës, anëtar
3. Shefki Sadiku, Drejtorati për Administratë, anëtar

Neni 2
Detyrat, përgjegjësitë e Komisionit

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë si vijon:

- Bën shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave/aplikacioneve për ndarje të subvencioneve për fermerë prodhues të qumështit përkatësisht për implementimin e projektit : subvencionimi i qumështit për litër, të cilët kanë aplikuar sipas shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-9779 e datës 15.02.2024 të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari, brenda afatit prej 30 ditë pune pas pranimit të këtij Vendimi në pajtim me dispozitat e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43474 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019 si dhe shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-9779 e datës 15.02.2024.
- I rekomandon Kryetarit të Komunës listën e përfituesve në përputhje me kriteret e përcaktuara në shpalljen publike për ndarjen e subvencioneve dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores për ndarjen e subvencioneve.

- Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e tij i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.
- Rekomandimet e Komisionit merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.
- Komisioni pas shqyrtimit të kërkesave publikon listën preliminare të përfituesve ku palët e pakënaqura kanë drejtë ankese në Komisionin e ankesave brenda afatit 15 ditor nga dita e publikimit të listës.
- Pas përfundimit të procedurave të ankesave, Komisioni vlerësues shpallë listën finale nëse ka ndryshime nga ajo preliminare varësisht nga Vendimi i Komisionit të ankesave.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/01-14011

Lipjan, 08.03.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit Nr.08/L-176 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative Kapitulli XXV ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr.04/ L-179 për transportin rrugor si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE NGA FUSHA E TRANSPORTIT RRUGOR

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni i ankesave për shqyrtimin e ankesave të palëve të pakënaqura ndaj Vendimeve apo akteve të ndryshme administrative nga fusha e transportit rrugor, (në vazhdim të tekstit Komisioni), në këtë përbërje:

1. Rrahim Krasniqi, Drejtorati për Administratë, Kryesues
2. Islam Kaleshi, Zyra e Kryetarit të Komunës, anëtar
3. Behar Mjeku, Drejtorati për Inspeksion, anëtar

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati i Komisionit

Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati i Komisionit janë si vijon:

- Bën shqyrtimin e ankesave të palëve të pakënaqura ndaj Vendimeve apo akteve të ndryshme administrative nga fusha e transportit rrugor në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore.
- Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e tij i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.
- Pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, Komisioni merr vendim për secilën ankesë të parashtruar.
- Mandati i Komisionit është 4 (katër) vjeçar.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit ndërsa me kopjen e këtij Vendimi do të njoftohen Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim , Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 020/01-16010
Lipjan, 08.03.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF -NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve (klubeve sportive, shoqatave sportive) që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Nr.5-453/01-8080 të datës 09.02.2024, në përbërje si vijon:

1. Bekim Zaskoku, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Trimor Shamolli, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Shehide Sopa-Ibrahimi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Leotrim Pajaziti nga OJQ-të, anëtar
5. Kamer Podrimqaku, nga shoqëria civili në cilësinë e ekspertit të jashtëm, anëtar dhe
6. Uran Qeriqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare rezerv

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve (klubeve sportive, shoqatave sportive) për vitin 2024 që kanë aplikuar konform thirrjes publike për aplikim Nr.5-453/01-8080 të datës 09.02.2024, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Komisioni do t'i kryen detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-14356
Lipjan, më 12.03.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit Nr.03/L-2012 i Punës, nenit 25 të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR.01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës nxjerr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

Neni 1

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të stafit shëndetësor dhe të aplikantëve për punësim në stafin shëndetësor në kuadër të Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale të Komunës së Lipjanit, në këtë përbërje:

1. Arjeta Thaqi-Stublla, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Kryesuese
2. Mirjeta Cakolli-Bajqinca, QKMF - Lipjan, anëtar
3. Hazbi Ademi, jurist në Zyren e Kryetarit të Komunës, anëtar

Neni 2

1. Detyrë e Komisionit është shqyrtimi i ankesave nga marrëdhënia e punës të stafit shëndetësor të cilët vlerësojnë se u janë shkelur të drejtat nga marrëdhënia e punës dhe të aplikantëve për punësim në stafin shëndetësor konform dispozitave të Ligjit Nr.03/L-2012 i Punës, Udhëzimit Administrativ MFPT-NR.01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik si dhe Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative.
2. Mandati i Komisionit është tre vjeçar.

Neni 3

Punët e pranimit të ankesave dhe punët tjera administrativo-juridike për Komisionin do ti kryej Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/01-15963
Lipjan, më 22.03.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021, Kryetari i Komunës nxjerr,

VENDIM

MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR DRAFT –PLANIN E VEPRIMIT PËR MBROJTJE
NGA DHUNA NË FAMILJE (2024-2026)

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Draft – Plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje (2024-2026).

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Draft- Plan mund ti dërgohen Komisionit për hartimin e Draft- Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje (2024-2026).ose në email adresën fjolla.ibrahimi@rks-gov.net, më së largu me datë 22.03.2024.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës .

1Nr. 020/dl-13912
Lipjan, më 07.03 2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Na osnovu članova 13, 58 i 68 stav 68.4 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br.03/L-040, Službena Novina Republike Kosova, br.28 dt. 4 juni 2008, članova 40, 41 i 67 Statuta Opštine Lipljan 15Br.110-78095 dt. 24.12.2021, Administrativno Upustva (MUP) Br.04/2023 za u pravu open u open u opštini, Uredba o Transparentnosti u Opštini Lipljan Br. 15-353-35739, dt.30.06.2021, Predsednik Opštine donosi:

ODLUKA

O JAVNOJ KONSULTACIJI ZA PROJEKT- AKCIONI PLAN ZA ZAŠTITU OD NASILJA U PORODICI (2024-2026)

Član 1

U cilju sprovođenja konsultacija i učešća javnosti, u usvajanju akata iz nadležnosti Opštine, objaviti na Websajt Opštine:

Projekt- Akcioni Plan Za Zaštitu od nasilja u porodici (2024-2026).

Član 2

Primedbe i sugestije na ovaj Projekt –Plan mogu se poslati Radnoj Komisiji za izradu Projekt- Akcioni Plan Za Zaštitu Od Nasilja U Porodici (2024-2026) na email adresu: fjolla.ibrahimi@rks-gov.net, naj kasnije do 22.03.2024.


Član 3

Ova Odluka stupa na snagu danom usvajanja i biće objavljena na Websajt Opštine.

1Br. 020/01-13912
Lipljan, 07.03.2024

PREDSEDNIK OPŠTINE

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021, Kryetari i Komunës nxjerr,

VENDIM
MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR PROJEKT- S T A T U T I N
E
QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE "Dr. MEHDI ZEJNULLAHU" NË
LIPJAN

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Projekt - Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr. MEHDI ZEJNULLAHU" në Lipjan.

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Projekt - Statut mund ti dërgohen Komisionit për hartimin e Projekt - Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr. MEHDI ZEJNULLAHU" në Lipjan ose në email adresën shkelzen.Hajdini@rks-gov.net, më së largu me datë 18.03.2024.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës .

1Nr. 020/01-13184
Lipjan, më 06.03.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Na osnovu članova 13, 58 i 68 stav 68.4 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br.03/L-040, Službena Novina Republike Kosova, br.28 dt. 4 juni 2008, članova 40, 41 i 67 Statuta Opštine Lipljan 15Br.110-78095 dt. 24.12.2021, Administrativno Upustva (MUP) Br.04/2023 za u pravu open u open u opštini, Uredba o Transparentnosti u Opštini Lipljan Br. 15-353-35739, dt.30.06.2021, Predsednik Opštine donosi:

ODLUKA
O JAVNOJ KONSULTACIJI ZA PROJEKT - S T A T U T

GLAVNOG CENTRA PORODIČNE MEDICINE "Dr. MEHDI ZEJNULLAHU" U LIPLJAN

Član 1

U cilju sprovođenja konsultacija i učešća javnosti, u usvajanju akata iz nadležnosti Opštine, objaviti na Websajt Opštine:

Projekt- Statut Glavnog centra porodične medicine "Dr. MEHDI ZEJNULLAHU" u lipljan

Član 2

Primedbe i sugestije na ovaj Projekt – Statut Glavnog centra porodične medicine "Dr. MEHDI ZEJNULLAHU" u lipljan na email adresu: Shkelzen.hajdini@rks-gov.net, naj kasnije do 88.03.2024.

Član 3

Ova Odluka stupa na snagu danom usvajanja i biće objavljena na Websajt Opštine.

1Br. 020/01-13184
Lipljan, 04.03.2024

PREDSEDNIK OPŠTINE
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **6,160.00€**, (gjashtë mijë e njëqindë e gjashtëdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-12614 e datës 01.03.2024, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 22 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin shkurt të vitit 2024 me nga 280 euro për secilin rast $22 \times 280 = 6,160.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryeatrit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-12614
Lipjan, më 01.03.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 9 par. 9 të Rregullores MF –Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 si dhe Rekomandimit të Komisionit për vlerësimin e pasurisë komunale Nr.01-400/01-15005 i datës 15.03.2024, Kryetari i Komunes, nxjerr

**VENDIM
PËR TJETËRSIMIN-ASGJËSIMIN E OBJEKTIT TË VJETËR TË SHTËPISË SË
KULTURËS NË LIPJAN**

Neni 1

TË ASGJËSOHET- RRËNOHET, Objekti i vjetër i Shtëpisë së Kulturës në Lipjan në pronësi komunale me ID të artikullit të pasurisë në SIMFK 200700000003158 në bazë të Rekomandimit të Komisionit për vlerësimin e pasurisë komunale Nr.01-400/01-15005 i datës 15.03.2024.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Prokurim.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtorati për Prokurim dhe Zyrtari për pasuri.

1Nr. 400/01-15005
Lipjan, më 18.03.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM PËR CAKTIMIN E ZYRTARËVE PËRGJEGJËS

I.Me këtë Vendim, caktohen zyrtarët përgjegjës komunalë të cilët do ta ndihmojnë Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari përkitazi me procesin e aplikimit të fermerëve të Komunës së Lipjanit për pagesat direkte në bujqësi, sipas Thirrjes për aplikim për vitin 2024 e cila do të shpallet nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ,në përbërje si vijon:

1. Fatbardha Shurdhiqi, Drejtorati për Infrastrukturë
2. Fitore Buja, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim
3. Arbëresha Hetemi, Zyra Lokale për Komunitete
4. Saranda Krasniqi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa
5. Pranvera Krasniqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport

II. Zyrtarët përgjegjës të cekur më lartë brenda periodës sa zgjat Thirrja publike do të jenë të angazhuar dhe do të punojnë sipas udhëzimeve të Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari përmes sistemit përkatës elektronik.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit ndërsa me kopjen e këtij Vendimi do të njoftohen Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari dhe zyrtarët përgjegjës të cekur në pikën I të këtij Vendimi.

INr. 112/02-14355
Lipjan, 12.03.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

